



PASQYRA MAKROEKONOMIKE

Departamenti i Makroekonomisë përdorë të dhëna të publikuara nga institucionet relevante. Të gjitha burimet e të dhënave janë të paraqitura në fund të këtij publikimi.

Projekcionet Makroekonomike

Nr.08, Janar – Mars 2012



Bazuar në trendin e komponentëve të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), gjatë vitit 2011 ekonomia e Kosovës vlerësohet të jetë rritur me një normë vjetore **prej 5.3%**. Përderisa parashikimet për vitin 2012, duke marrë për bazë zhvillimet rajonale dhe zhvillimeve në euro zonë, tregojnë për një rritje vjetore **prej 4.4%**.

Edhe gjatë vitit 2012, **konsumi i përgjithshëm**, pritet të jetë kontribuuesi kryesor në rritjen e Bruto Prodhimit Vendor, duke kontribuar në rritje me 2.4%. **Konsumi privat**, parashikohet të kontribuoj në rritje reale me 2.1%.

Gjatë vitit 2012 **investimet e përgjithshme** (publike dhe private) priten të jenë një faktor i rëndësishëm ne rritjen ekonomike. **Investimet e përgjithshme** parashikohen të kontribuojnë në rritjen vjetore të BPV me rreth **2.3%**.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve pritet të kontribuojnë me rreth 1.3%, përderisa, **importet** e mallrave dhe shërbimeve pritet të vazhdojnë me kontribut negativ në rritjen ekonomike me rreth -1.7%.

Gjatë vitit 2011, norma mesatare vjetore e rritjes së **Indeksit të Çmimeve të Konsumit** (IÇK) shënoj **7.3%** nga 3.5% sa ishte në vitin 2010. Përderisa, IÇK përgjatë vitit 2012 pritet të jetë rreth **1.2%**.




Sektori Real

Çmimet e përgjithshme të matura nga Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (IÇK) vazhduan trend **rënës** përgjatë tre mujorit të parë të vitit 2012. Në mesatare IÇK shënoj një rritje prej 1.7% në tremujorin e parë të vitit 2012, shifër e cila në periudhën e njëjtë të vitit 2011 ishte 9.2%.

Sic mund të shihet nga grafiku, pas një ngritje të theksuar në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në pjesën e parë të vitit 2011, çmimet në pjesën e dytë të vitit filluan të bien për të arritur në 0.6% ndryshim vjetorë në muajin Mars të vitit 2012. Kjo vlerë është ngritjen më e ulët përgjatë dy viteve të kaluara.

Indeksi i Çmimit të Konsumatorit, IÇK (në %)



Faktorët kryesor në ngritjen e çmimeve të përgjithshme përgjatë tre majorit të parë të vitit 2012 vërehet të janë **nafta dhe benzina** përderisa rënienë në çmime vërehet të kenë pasur **buka dhe drithërat**.

Si rezultat i zhvillimeve në çmimet e mallrave nëpër tregjet globale, parashikimet e fundit për nivelin e përgjithshëm të çmimeve botërore tregojnë për një stabilizim të përgjithshëm të çmimeve. Çmimet e ushqimit priten të janë nxitësit kryesor në luhatjen e çmimeve gjatë periudhës së parashikuar si rezultat i peshës së madhe që këto të mira kanë në shportën e konsumatorit vendorë. Megjithatë, si rezultat i stabilizimit të çmimit të këtyre produktave, këto zhvillime priten të reflektohen në nivelin e çmimeve në tregun vendor.

Si rezultat i zhvillimeve gjeo-politike në lindjen e mesme dhe më gjerë, lëvizjet e çmimeve të naftës dhe benzinës priten të janë një faktor shtesë i rëndësishëm në determinimin e nivelit të çmimeve vendore përgjatë vitit.

Si rezultat i këtyre ngjarjeve dhe zhvillimeve në tregun vendorë, parashikohet se çmimet vendore përgjatë vitit 2012 priten të rriten me një mesatare prej **1.2%** në raport me vitin 2011.


Sektori i Jashtëm

Niveli i **eksporteve dhe importeve** përgjatë tremujorit të parë të vitit 2012 ishte më i ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, megjithatë, bilanci tregtar nuk u përmirësua. Kjo si rezultat i rënies më të madhe të eksportave të mallrave në raport me rënien e importit të mallrave.

Kjo rënie në tregtinë me jashtë i atribuohet kryesisht kushteve atmosferike mjaft të pafavorshme që vështërsuan qarkullimin rrugorë, ku muaji Shkurt shënoj dhe rënien më të theksuar, si për importe ashtu dhe për eksporte, përgjatë këtij tremujori.

Vlera e mallrave të eksportuara në fund të tre majorit të parë të vitit 2012 arriti vlerën prej **€58.2 milion**. Shifër e cila është më e ulët se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar përfshin €17 milion.

Sikurse gjatë viteve paraprake, **metalet bazë** ishin produktet kryesore të **eksportuara**, pasuar nga produktet e minraleve, produktet ushqimore, plastika dhe druri, makineritë dhe pajisjet elektrike.



Për më shumë, partnerët kryesor tregtar mbetën të njëjtit sikurse në periudhat paraprake, ku vendet e BE-së mbësin destinacioni kryesor i produkteve nga Kosova.

Importet e mallrave gjithashtu ishin në nivel më të ulët se sa periudha e njëjtë vitit të kaluar, megjithatë, rikuperimi i importeve vërehet të jetë më i shpejt se sa eksportet.

Vlera nominale e importeve në fund të tre majorit të parë të vitit 2012 arriti në €457.6 milion, shifër e cila prezanton një **rënje** prej afro **3%** në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Produktet minerale (kategori e cila përfshinë importin e naftës) është kategoria kryesore e importuar, pasuar nga Ushqimi i Përgatitur, Pijet dhe Duhani.

Si rezultat i rritjes më të ngadalshme të eksporteve, bilanci negativ tregtar mbeti në nivel të njëjtë në raport me vitin paraprak.

Sektori Fiskal

Të hyrat e përgjithshme në fund të tremujorit të parë të vitit 2012 shënuan **€287.2** milion, duke përfaqësuar realizim prej rreth 20% të planifikimit vjetor.

Si rezultat i importit më të ulët, shkaktuar kryesisht nga kushtet atmosferike, të hyrat nga dogana rezultuan të jenë në nivel më të ulët se sa periudha e njëjtë e vitit te kaluar.

Të Hyrat nga Dogana në fund të tremujorit të parë të vitit shënuan €142.5 milion, shifër e cila është më e ulët për rreth 4% në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

Në anën tjetër, të hyrat nga **Tatimet Vendore** shënuan ngritje prej rreth 9% në raport me vitin e kaluar duke shënuar vlerë prej rreth €64.7 milion në fund të tre mujorit të parë të vitit 2012. Kjo shifër njëherazi përfaqëson 22% realizim të planit vjetor.


Shpenzimet totale Qeveritare në fund të muajit Mars kapën vlerën prej €286.7 milionë, duke shënuar ngritje prej afro €111.4 milion krahasuar me tre mujorin e vitit paraprak.

Shpenzimeve kapitale u ngritën për **rreth €75 milion**, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzime këto kryesisht të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e autostradës Merdare Morinë.


Gjithashtu, ngritje patën dhe **shpenzimet rrjedhëse** për rreth **42%** si rezultat i rritjes së kategorisë për paga dhe mëditje pas ngritjes së pagave për kategori të caktuara të shërbyesve civil.

Kjo ngritje e theksuar në shpenzimet Qeveritare në raport me vitin e kaluar erdh si rezultat i mos aprovimit të buxhetit vjetor në kohë për vitin 2011 dhe se gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin për buxhet të vitit 2011 funksionoj me 1/12 e buxhetit të vitit 2011.

Të hyrat buxhetore, në milion euro



Shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në miliona euro



Sektori Financiar

Asetet totale të sektorit bankar në fund të muajit Mars të vitit 2012 arritën në **€2.6 miliard**, shifër e cila përfaqëson një ngritje për 6.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitin 2011.

Totali i **depozitave** në sektorin bankar deri në fund të muajit Mars arritën vlerën në rreth **€2.1 miliardë** duke shënuar ngritje vjetore prej **8.7%**.

Kreditë arritën vlerën prej **€1.7 miliardë** në fund të muajit Mars 2012 duke shënuar një **ngritje vjetore** prej **13.5%**. Nga këto kredi rreth 66.5% ishin të drejtuara për korporatat jo financiare dhe pjesa e mbetur për ekonomitë familjare. Sektorët me pjesëmarrje më të madhe në kredi-marrje ishin sektori i shërbimeve, energetikës, industriisë dhe ndërtimtarisë.

Norma mesatare e **interesit në kredi** shënoj **13.8%** gjatë muajit Mars të vitit 2012, ndërsa norma e **interesit në depozita** shënoj **3.33%**.

Tabela 1.

Agregatet kryesor ekonomik dhe fiskal

Përshkrimi	2011			2012								
	Janar	Shkurt	Mars	Janar	Shkurt	Mars						
	(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet ndryshe)			(në miliona Euro, vetëm nëse tregohet)								
Rritja vjetore e BPV -së												
Sektori Real												
IÇK (në %)	7.4	9.5	10.8	2.9	1.7	0.6						
Projekzioni I IÇK-së (në %)												
Sektori i Jashtëm												
Importi i Mallrave	132.7	148.9	190.5	132.2	125.2	200.2						
Eksporti i Mallrave	22.9	25.7	26.4	19.1	15.3	23.8						
Bilanci tregtar	-109.9	-123.2	-164.1	-113.1	-109.9	-176.4						
Sektori Fiskal												
Të hyrat e përgjithshme	83.2	71.2	89.5	93.4	82.0	111.9						
Të hyrat nga kufiri	44.3	48.7	56.0	40.1	45.7	56.8						
Të hyrat vendore	32.4	13.7	13.2	29.3	20.1	15.3						
Të hyrat jo tatimore	3.0	3.1	4.5	3.4	2.3	3.5						
Te hyrat nga dividenta	-	-	5.0	-	-	15.0						
Mbështetja buxhetore	-	-	-	1	-	-						
Pranimet nga emetimi I letrave me vlere				9.9	9.9	9.9						
Shpenzimet e përgjithshme	36.4	89.5	49.3	30.1	148.2	108.4						
Shpenzimet Rrjedhëse	14.6	76.4	33.3	22.7	73.1	81.1						
Shpenzimet Kapitale	20.9	2.6	13.2	7.4	75.1	27.3						
Sektori Financiar												
Depozitat	1,902.1	1,918.2	1,919.4	2,113.5	2,123.4	2,087.5						
Kreditë	1,460.2	1,484.0	1,513.2	1,683.1	1,692.2	1,717.1						
MHN te korporatave financiare			2,042.5			2,087.9						

Burimi i të dhënavë:Sektorit Real: Enti i Statistikave te Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>Sektori Fiskal: Departamenti i Thesarit, MEF: <http://www.mef-rks.org/>Sektori Financiar dhe Sektori i Jashtëm: Banka Qendrore e Kosovës : <http://www.bqk-kos.org/>